



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCES**

NJOFTIM PËR SHTYP

Raporti i progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë vlerëson progresin në fushën e konkurrencës

Komisioni Evropian ka publikuar sot Raportin e Progresit për Shqipërinë duke vlerësuar se “progres është bërë në veçanti për sa i përket antitrust- it dhe kontrollit të përqëndrimeve”.

Sa vijon teksti i plotë i përkthyer i kapitullit 8-Politika e Konkurrencës(vetëm për pjesën e Autoritetit të Konkurrencës).

-Rregullat e BE- së mbrojnë konkurrencën e lirë. Ato përfshijnë rregullat e anti-trust kundër marrëveshjeve kufizuese ndërmjet kompanive dhe rregullat për abuzimin me pozitën dominuese. Rregullat e BE- së gjithashtu parandalojnë që qeveritë të japin ndihma shtetërore që deformojnë konkurrencën.

Progres të moderuar ka patur në politikën e konkurrencës. Progres është bërë në veçanti për sa i përket antitrust- it dhe kontrollit të përqëndrimeve.

Autoriteti i Konkurrencës (AK) miratoi udhëzimet për vlerësimin dhe abuzimin me pozitën dominuese në treg **në lidhje me antitrust dhe përqëndrimet**, dhe ka hartuar udhëzime të reja mbi kushtet detyruese në bazë të njoftimit të Komisionit Evropian mbi kushtet detyruese.

Kapaciteti administrativ i AK-së është i mjaftueshëm dhe **stafi i saj ka një nivel të mirë të ekspertizës**. Megjithatë, vonesat në proceset gjyqësore janë shumë të gjata dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme për të rritur disponueshmërinë dhe cilësinë e trajnimeve për gjyqtarët mbi politikën e konkurrencës.

Sa i përket liberalizimit, një vlerësim ex post i Autoritetit të Konkurrencës zbuloi se autoritetet kontraktuese nuk e kishin përmbushur detyrimin e tyre për të kërkuar një vlerësim nga Autoriteti i Konkurrencës për dhënien e të drejtave ekskluzive.